



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 732, datë 16.9.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR**  
**NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN**  
**E RIKONSTRUKSIONIT OSE TË RIPARIMIT TË BANESAVE**  
**INDIVIDUALE, TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)**  
**SI DHE MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA**  
**NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË KRUJË, SHIJAK,**  
**DURRËS DHE TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 1 442 493 401 (një miliard e katërqind e dyzet e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e një) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, dhe rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:
  - a) Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 86 000 000 (tetëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin

e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para;

- b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 63 588 401 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e një) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin për rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat);
- c) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 763 250 000 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para;
- ç) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 529 655 000 (pesëqind e njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**